**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 01/113**
**Datë: 16.12.2022**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 6, paragrafi 4. të Ligjit 05/L-081 për Energjinë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031.

2. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Strategjia nga pika 1. e këtij Vendimi, i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeminister i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 02/113**
**Datë: 16.12.2022**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Kinematografinë.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Nr. 03/113**
**Datë: 16.12.2022**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2022, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.05/L-081për Energjinë.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 04/113**
**Datë: 16.12.2022**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Rininë.

2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 05/113**
**Datë: 16.12.2022**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2022, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Programi Edukativ për nxënësit e klasës të njëmbëdhjetë (11) të Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë "Edukimi për Siguri".

2. Shuma që parashihet për zbatimin e Programit për periudhën 1 vjeçare, viti shkollor 2022-2023 është 350,000.00 € (treqindepesëdhjetë mijë euro).

3. Shuma e paraparë në pikën 2. të këtij Vendimi shërben për përgatitjen e infrastrukturës adekuate fizike për zhvillimin e aktiviteteve të programit, angazhimin e stafit profesional, transportin e nxënësve dhe stafit të angazhuar, si dhe sigurimin e shujtës ditore për të gjithë pjesëmarrësit.

4. Ministritë përkatëse sipas kompetencave të tyre janë përgjegjëse për caktimin e kushteve dhe kritereve për implementimin e Programit si në pikën 1. të këtij Vendimi.

5. Obligohen ministritë përkatëse që të përfshijnë shumat për zbatimin e Programit si në pikën 1. të këtij Vendimi, brenda kufijve buxhetor për vitet përkatëse.

6. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që në koordinim me Ministrinë e Mbrojtjes të caktojë një Grup Punues Ndërinstitucional për zbatimin e programit.

7. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Komunat për zbatimin e këtij Vendimi.

8. Pjesë e këtij Vendimi është shtojca, Programi "Edukimi për siguri".

9. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

______________________

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Plan-programi i Lëndës "Edukim për Siguri"

| Nr. | Lëndët dhe Temat Mësimore | Fondi i orëve: Teori dhe Praktikë | Nr. i orëve | Realizohet nga: |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Historiku dhe vlerat e institucioneve të sigurisë | Teori 2 orë | 2 | FSK/PK |
| 2. | Ligji i Konfliktit të Armatosur | Teori<br>2 orë | 2 | FSK |
| 3. | Arkitektura e Institucioneve të Sigurisë së Kosovës<br>3.1.Struktura Organizative e FSK<br>3.2.Struktura Organizative e Policisë se Kosovës<br>3.3.Struktura Organizative e AME-së<br>3.4.Struktura Organizative e AKI-së | Teori<br>1 orë<br>1 orë<br>1 orë<br>1 orë | 4 | FSK<br>PK<br>AME<br>AKI |
| 4. | Orientimi në Natyrë/Leximi i Hartave<br>4.1.Hyrje në Topografi/ veçoritë e terrenit<br>4.2.Përdorimi i hartës<br>4.3.Përdorimi i busullës<br>4.4.Përdorimi i GPS | Teori 4 orë<br>Praktikë 2 orë | 6 | FSK |
| 5. | Ndihma e Parë<br>5.1.Vlerësimi i viktimës<br>5.2.Dhënia e ndihmës së parë (gjakderdhja, thyerjet, djegiet, KPR)<br>5.3.Mobilizimi i viktimës<br>5.4.Llojet e bartjes | Teori 4 orë<br>Praktikë 4 orë | 8 | Kryqi Kuq<br>i Kosovës |
| 6. | Njohja me pajisjet e FSK<br>6.1.Llojet dhe specifikat e pajisjeve<br>6.2.Përdorimi i sigurt i pajisjeve ushtarake<br>6.3.Përdorimi taktik i pajisjeve | Teori 2 orë<br>Praktikë 2 orë | 4 | FSK<br>PK |
| 7. | Armët e Shkatërrimit në Masë<br>7.1.Armët Nukleare<br>7.2.Armët Kimike<br>7.3.Armët Biologjike | Teori 3 orë | 3 | FSK |
| 8. | Mjetet eksplozive<br>8.1. Minat<br>8.2. Eksplozivët<br>8.3. Mjetet piroteknike | Teori 3 orë | 3 | FSK |
| 9. | Mbrojtja Civile<br>9.1. Katastrofat natyrore (tërmetet, zjarret, përmbytjet, shpërthimet)<br>9.2. Reagimi ndaj emergjencave civile (reagimi individual dhe ofrimi i mbështetjes gjatë emergjencave civile) | Teori 4 orë | 4 | FSK |
| 10. | Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore | Teori 2 orë | 2 | Ministria e Kulturës |
| 11. | Edukimi Fizik në Institucionet e Sigurisë | Teori 1 orë<br>Praktikë 3 orë | 4 | FSK |
| 12. | Ndërtimi i ekipit<br>12.1. Udhëheqja dhe llojet e udhëheqjes<br>12.2. Menaxhimi i personelit dhe resurseve<br>12.3. Puna ekipore në kompletimin e misionit | Teori 2 orë<br>Praktikë 2 ditë | 4 | FSK |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 13. | Rreziqet nga teknologjia dhe efektet e saj në shoqëri<br>13.1. Menaxhimi i mençur rrjeteve sociale | Teori 2 orë | 2 | PK |
| 14. | Ndërtimi i kampit<br>14.1. Administrimi i personelit<br>14.2. Administrimi i pajisjeve | Teori 2 orë | 2 | FSK |
| 15. | Epidemiologjitë dhe veprimet sanitare<br>15.1. Higjiena personale<br>15.2. Higjiena sanitare brenda kampit | Teori 2 orë | 2 | Ministria e Shëndetësisë |
| 16. | Kërkim Shpëtim<br>16.1. Kërkim Shpëtim Urban<br>16.2. Kërkim Shpëtim Ujera<br>16.3. Kërkim Shpëtim Male | Teori 6 orë | 6 | FSK |
| 17. | Rekrutimi në institucione të sigurisë<br>17.1. Si t'i bashkëngjitëm FSK<br>17.2 Si t'i bashkëngjitëm PK | Teori 2 orë | 2 | FSK dhe PK |
| | **Totali i fondit të orëve:** | **Teori/praktikë 60 orë** | **60 orë** | |

*Plan-programi i Kampit Fushor është i paraqitur në shtojcën A të këtij koncepti.

- **Parashikimet buxhetore në javën e tretë – sipas konceptit shtatë regjione teori me nga 300 nxënës dhe kamp fushor me 300 nxënës të përzgjedhur nga shtatë regjionet:**

Tabela 1: Shujtat e ushqimit për nxënësit

| Nr | Shujtat e Ushqimit për nxënësit | Kosto e Ushqimit | Shënim |
|---|---|---|---|
| 1. | Mëngjesi | 2x2400=4800 euro<br>4800x15 ditë= 72000 euro | Shujta e mëngjesit ofrohet për të gjithë nxënësit pjesëmarrës edhe në pjesën teorike dhe atë praktike |
| 2. | Dreka | 5x300=1500<br>1500x5 ditë = 7500 euro | |
| 3. | Darka | 3x300=900 euro<br>900x5 ditë = 4500 euro | |
| 4 | **Totali i kostos së përgjithshme** | **€84 000** | |

Kosto e përafërt e shujtave e ushqimit për stafin përcaktohet pas përcaktimit të numrit të përgjithshëm të stafit

Tabela 2: Ujë të pijshëm

| Nr. | Ujë të pijshëm | Kosto e Ujit | Shënim |
|---|---|---|---|
| 1. | Nxënësit dhe stafi | 0.30x2400=720 euro<br>720x15 = 10800 euro<br>10800x 2 shishe= 21600 | Rekomandohet që minimumi të jetë 2 shishe ujë për një person (sidomos gjatë kampit fushor) |
| 2 | **Total kosto e përgjithshme** | **€21600** | |

Kosto totale financiare e përafërt për periudhën pesëmbëdhjetë ditore për ushqim dhe ujë duke përfshirë dhe një shujtë për pjesën teorike: **105600 euro.**

**Mbështetja me pajisje përcjellëse për ndërtimin e kampit:**

| Nr | Pajisjet | Sasia | Shënim |
|---|---|---|---|
| 1. | Shtretër fushorë | 350 copë | FSK mund të huazoj këtë sasi të shtretërve fushor. |
| 2 | Dyshek fushorë | 350 copë | |

**Kursi i Veprimit :** Pjesa praktike realizohet në terren 24/7 gjatë pesë ditëve të javës:

- MM/FSK të bëjë blerjen e pajisjeve logjistike (shtretër fushorë, tenda, dyshek fushorë, thasë për fjetje) që shfrytëzohen vetëm për këtë qëllim (gjatë planifikimit të buxhetit të MM/FSK të planifikohet vijë e veçantë për këtë qëllim).
- MASHTI të ofrojë tre racione ushqim përgjatë gjithë kohës së realizimit të kampit fushorë.
- MASHTI të ofrojë transportin gjatë realizimit të projektit (MASHTI të kalkuloj koston e përafërt të këtij projekti).
- Angazhimi i Policisë Ushtarake dhe Policisë së Kosovës për sigurinë e kampit;
- Higjiena në kamp dhe sigurimi i WC fushore për 300 nxënës si dhe stafin e instruktorëve realizohet nga MM/FSK;
- Sigurimi i banjave fushore për higjienë personale për 300 nxënës realizohet nga MM/FSK;
- Mbështetja me ekipe mjekësore 24/7 realizohet nga Ministria e Shëndetësisë;
- Shuma e mëditjeve për stafin trajnues përcaktohet nga MASHTI.
- Numri i stafit trajnues përcaktohet nga grupi ndërinstitucional për implementim.

**Rekomandim:**

Pasi që ky program është vetëm pilot projekt rekomandojmë që nga të gjitha regjionet të përzgjidhen 300 nxënës me qëllim të realizimit të kampit fushor. Rekomandohet që kampi fushor të vendoset në hapësirat e ndonjë shkolle që nuk është aktualisht funksionale në regjionin e Prishtinës. Gjithashtu rekomandojmë që për implementimin e këtij projekti të krijohet një grup ndërinstitucional për implementim.

**Vërejtje:** Ky është vetëm një draft fillestar i cili mund të plotësohet apo ndryshohet sipas kërkesave dhe nevojave të programit. Dakordimi me MASHTI është që ndërkohë të punohet në përfshirjen e Lëndës "Edukimi për Siguri" si lëndë e rregullt në kuadër të kurrikules mësimore në shkollat e mesme.

Shtojca A: Programi i Kampit Fushor

| Nr. | Dita | Koha | Personeli | Aktiviteti | Lokacioni |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | E Hane | 0800 - 0900 | Studentët | Arritja në kamp/ | Të përcaktohet |
| | | 0900 - 1200 | | Pjesa administrative (pranimi i pajisjeve/ vendosja në tenda) | Të përcaktohet |
| | | 1200 - 1300 | | Dreka | |
| | | 1300 - 1700 | | Orientimi në Natyrë/Leximi i Hartave<br>- Hyrje në Topografi/ veçoritë e terrenit<br>- Përdorimi i hartës<br>- Përdorimi i busullës<br>- Përdorimi i GPS | |
| | | 1800 - 1900 | | Darka | |
| | | 1900 - 2200 | | Kohë e lirë | |
| 2 | E Marte | 0700 - 0830 | Studentët | Mëngjesi/ higjiena personale | |
| | | 0830 - 1200 | Studentët | Ndihma e Parë<br>- Vlerësimi i viktimës<br>- Dhënia e ndihmës së parë (gjakderdhja, thyerjet, djegiet, KPR) | |
| | | 1200 - 1300 | Studentët | Dreka | |
| | | 1300 - 1800 | Studentët | Ndihma e Parë<br>- Mobilizimi i viktimës<br>- Llojet e bartjes | |
| | | 1800 - 1900 | Studentët | Darka | |
| | | 1900 - 2100 | Studentët | Kohë e lirë | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3 | E Mërkurë | 0700 - 0830 | Studentët | Mëngjesi/ Higjena personale | |
| | | 0830 - 1200 | Studentët | Armët dhe Përdorimi i tyre<br>- Llojet dhe specifikat e armëve<br>- Përdorimi i sigurt i armës (montim dhe çmontim)<br>- Pozicionet e qitjes | |
| | | 1200 - 1300 | Studentët | Dreka | |
| | | 1300 - 1800 | Studentët | Kerkim Shpetimi (Urban, Ujera dhe Male) | |
| | | 1800 - 1900 | Studentët | Darka | |
| | | 1900 - 2100 | Studentët | Kohë e lirë | |
| 4 | E Enjte | 0700 - 0830 | Studentët | Mëngjesi/ higjena personale | Të përcaktohet |
| | | 0800 - 1200 | Studentët | Mbrojtje nga Sulmet e Armëve të Shkatërrimit në Masë<br>- Përdorimi i gaz-maskës | |
| | | 1200 - 1300 | Studentët | Dreka | |
| | | 1300 - 1800 | Studentët | Evakuimi në Emergjenca Civile<br>- Katastrofat natyrore (tërmetet, zjarret, përmbytjet, shpërthimet)<br>- Reagimi ndaj emergjencave civile (reagimi individual dhe ofrimi i mbështetjes gjatë emergjencave civile) | |
| | | 1800 - 1900 | Studentët | Darka | |
| | | 1900 - 2100 | Studentët | Kohë e lirë | |
| 5 | E Prem | 0700 - 0830 | Studentët | Mëngjesi/ higjena personale | Të përcaktohet |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 0800 - 1200 | Studentët | Edukimi Fizik në Institucionet e Sigurisë | |
| | | 1200 - 1300 | Studentët | Dreka | |
| | | 1300 - 1600 | Studentët | Kthimi i pajisjeve dhe përmbyllja e kampit | |

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 06/113**
**Datë: 16.12.2022**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafit 4 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-143, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje, sipas tabelave të bashkangjitura në aneksin A (Kursimet) dhe në aneksin B (Ndarjet).

2. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Aneks A (Kursimet)**

| BLLOKU KODUES | ORGANIZATA | PROGRAMI | KAT | KATEGORIA | TE LIRA |
|---|---|---|---|---|---|
| 10/214/12100/13/00000/0131 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT SHERBI | 13 | MALLRA DHE SHERBIME | 90,000.00 |
| 10/214/14800/13/00000/0160 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | AGJENSIONI I REGJISTRIMIT CIVIL | 13 | MALLRA DHE SHERBIME | 600,000.00 |
| 10/214/20900/13/00000/1070 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | RI INTEGRIMI I PERSONAVE TE RIATDHESU | 13 | MALLRA DHE SHERBIME | 60,000.00 |
| **Total-Kursime në mallra dhe shërbime** | | | | | **750,000.00** |
| 10/214/11314/14/00000/0360 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | SHERBIMET ADMINISTRATIVE QENDRORE | 14 | SHPENZIME KOMUNALE | 50,000.00 |
| 10/214/12300/14/00000/0133 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE PO | 14 | SHPENZIME KOMUNALE | 300,000.00 |
| 10/214/12600/14/00000/0133 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | AGJENSIONI I SHOQERISE SE INFORMACIO | 14 | SHPENZIME KOMUNALE | 20,000.00 |
| 10/214/14800/14/00000/0160 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | AGJENSIONI I REGJISTRIMIT CIVIL | 14 | SHPENZIME KOMUNALE | 50,000.00 |
| 10/214/20900/14/00000/1070 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | RI INTEGRIMI I PERSONAVE TE RIATDHESU | 14 | SHPENZIME KOMUNALE | 90,000.00 |
| 10/214/35000/14/00000/0360 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | AGJENCIA E KOSOVES - FORENZIKE | 14 | SHPENZIME KOMUNALE | 40,000.00 |
| 10/221/11321/14/00000/0131 | MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL | ADMINISTRATA QENDRORE - MZHR | 14 | SHPENZIME KOMUNALE | 9,500.00 |
| **Total-Kursime në shpenzime komunale** | | | | | **559,500.00** |
| 10/214/20900/20/00000/1070 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | RI INTEGRIMI I PERSONAVE TE RIATDHESU | 20 | SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | 400,000.00 |
| 10/213/42300/20/00000/0460 | MINISTRIA E EKONOMISE | DEPARTAMENTI I POSTTELEKOMUNIKACI | 20 | SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | 1,000,000.00 |
| **Total Kursime në subvencione dhe transfere** | | | | | **1,400,000.00** |
| 10/221/11321/30/16013/0451 | MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL | ADMINISTRATA QENDRORE - MZHR | 16013 | NDERTIMI I STACIONIT TE AUTOBUSEVE | 100,000.00 |
| 10/221/11321/30/16022/0451 | MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL | ADMINISTRATA QENDRORE - MZHR | 16022 | RREGULLIMI I STAZES PER KEMBESOR ME | 70,000.00 |
| 10/214/12600/30/14388/0133 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | AGJENSIONI I SHOQERISE SE INFORMACIO | 14388 | NGR E KAPAC. HARDU. QEND. DHENAVE S | 500,000.00 |
| 10/214/11314/30/15154/0133 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | SHERBIMET ADMINISTRATIVE QENDRORE | 15154 | NDERTIMIN E " RRETHOJES NE FUSHEN E | 11,499.00 |
| 10/214/12300/30/10012/0133 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE PO | 10012 | KOMPLEKSI I RI QEVERITAR, NE HAJVALI | 440,000.00 |
| 10/214/12300/30/12806/0111 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE PO | 12806 | NDERTIMI OBJEKTIT TE KPM | 171,383.00 |
| 10/214/14800/30/15716/0133 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | AGJENSIONI I REGJISTRIMIT CIVIL | 15716 | FURNIZIM ME PISJE REZERVE (KOPRESOR | 60,000.00 |
| 10/214/12300/30/13251/0330 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE PO | 13251 | DIZAJNIMI DHE NDERTIMI I ANEKSIT TE C | 100,000.00 |
| 10/214/12300/30/13550/0330 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE PO | 13550 | DIZAJNIMI DHE NDERTIMI I OBJEKTIT GJY | 130,000.00 |
| 10/214/12300/30/15057/0111 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE PO | 15057 | PROJEKTI BLINAJA | 200,000.00 |
| 10/214/12300/30/18007/0970 | MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME | DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE PO | 18007 | NDERTIMI I OBJEKTIT TE AKADEMISE SE | 200,000.00 |
| **Total -Kursime në shpenzime kapitale** | | | | | **1,982,882.00** |
| 10/221/11321/38/00000/0131 | MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL | ADMINISTRATA QENDRORE - MZHR | 38 | KATEGORIA E REZERVES | 114,053.00 |
| **Total -Kursime në KATEGORINE E REZERVES** | | | | | **114,053.00** |
| **Total Kursimet** | | | | | **4,806,435.00** |

**Aneks B (kerkesat)**

| BLLOKU_KODUES | ORGANIZATA | PROGRAMI | KAT | KATEGORIA | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|
| 10/214/12600/13/00000/0133 | MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME | AGJENSIONI I SHOQËRISË SË INFORMACIONIT | 13 | MALLRA DHE SHËRBIME | 2,160,000.00 |
| 10/214/35000/13/00000/0360 | MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME | AGJENCIA E KOSOVËS - FORENZIKË | 13 | MALLRA DHE SHËRBIME | 40,000.00 |
| 10/215/11315/13/00000/0330 | MINISTRIA E DREJTËSISË | ADMINISTRATA QENDRORE - MD | 13 | MALLRA DHE SHËRBIME | 48,553.00 |
| | | | | | |
| **Total-Ndarje në mallra dhe shërbime** | | | | | **2,248,553.00** |
| | | | | | |
| 10/213/23300/20/00000/0133 | MINISTRIA E EKONOMISE | NJESIA PER POLITIKAT DHE MONITORIMIN E NDERRMARRJEVE PUBLIKE | 20 | SUBVENCIONE DHE TRANSFERI | 1,000,000.00 |
| 10/221/11321/20/00000/0131 | MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL | ADMINISTRATA QENDRORE - MZHR | 20 | SUBVENCIONE DHE TRANSFERI | 245,000.00 |
| | | | | | |
| **Total-Ndarje në Subvencione dhe transfere** | | | | | **1,245,000.00** |
| | | | | | |
| 10/214/12300/30/12992/0133 | MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME | DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITI | 12992 | RENOVIMI I OBJEKTEV QEVERI | 682,882.00 |
| 10/214/12300/30/13216/0941 | MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME | DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITI | 13216 | NDERTIMI DHE PROJEKTIMI I D | 630,000.00 |
| | | | | | |
| **Total Ndarje në shpenzime kapitale** | | | | | **1,312,882.00** |
| **Total Ndarjet** | | | | | **4,806,435.00** |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 07/113**
**Datë: 16.12.2022**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49, 50 dhe nenit 52 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-175 për Borxhet Publike, të nenit 24 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2022, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet në parim kërkesa për huamarrje për 5,000,000.00 € (pesë milionë euro) për "Telekomin e Kosovës Sh. A.", subjekt i aprovimit nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, me qëllim përmbushjen e planit investiv.

2. Obligohet Thesari që për huadhënien ndaj Ndërmarrjes Publike të bëjë transferet dhe regjistrimet e nevojshme në regjistrat kontabël në kuadër të Sistemit Informatik për Menaxhimin e Financave të Kosovës.

3. Mjetet e huadhënies sipas këtij Vendimi përdoren vetëm për qëllimin e miratuar dhe nuk janë subjekt i asnjë kufizimi, pretendimi dhe detyrimi nga palët e treta.

4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 08/113**
**Datë: 16.12.2022**

Në mbështetje të nenit 17, 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Ngrohtorja Solare e Prishtinës".

2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë